

## V E N D I M

NR.303, DATE 1.7.1999

### PER KRIJIMIN E SISTEMIT TE AKREDITIMIT NE ARSIMIN E LARTE

Ne mbeshtetje te nenit 100 te Kushtetutes dhe te neneve 10 e 13 te ligjit nr.8461, date 25.2.1999 "Per arsimin e larte ne Republiken e Shqiperise", me propozimin e Ministrise se Arsimit dhe Shkences, Keshilli i Ministrave

### V E N D O S I:

1. Sistemi i akreditimit ka per funksion drejtimin dhe kryerjen e procesit te akreditimit ne shkollat e larta. Institucionet e sistemit te akreditimit te arsimit te larte ne Republiken e Shqiperise jane Keshilli i Akreditimit dhe Agjencia e Akreditimit, ne bashkepunim me Ministrine e Arsimit dhe Shkences.
2. Keshilli i Akreditimit eshte organ kolegjial, i cili emerohet nga Keshilli i Ministrave, me propozimin e Ministrise se Arsimit dhe Shkences. Statuti i tij miratohet nga Keshilli i Ministrave. Ai perbehet nga 11 vete, personalitete ne fushen e arsimit te larte, te shkences dhe te ekonomise shqiptare, me tituj shkencore, qe provojne pervojen dhe kompetencen akademike dhe shkencore. Anetare te Keshillit te Akreditimit jane gjashte perfaqesues te sistemit te arsimit te larte, dy perfaqesues te sistemit te institucioneve shkencore, dy perfaqesues te ekonomise shqiptare dhe nje perfaqesues i Ministrise se Arsimit dhe Shkences. Kryetari i Keshillit te Akreditimit shperblehet çdo muaj me 40 per qind te rrogës se profesorit, kurse anetaret me 30 per qind te rrogës se profesorit.
3. Agjencia e akreditimit eshte institucion publik, buxhetor, ne varesi te Ministrise se Arsimit dhe Shkences. Numri i punonjesve te kesaj agjencie eshte brenda numrit te punonjesve te planifikuar per vitin 1999, per sistemin e arsimit dhe te shkences dhe buxheti i saj per vitin 1999 mbulohet nga buxheti i miratuar per Ministrine e Arsimit dhe shkences. Per kryerjen e funksioneve Agjencia angazhon edhe punonjes te jashtem. Agjencia e Akreditimit i ka zyrat ne mjediset e Qendres se Informacionit dhe te Dokumentacionit Shkencor dhe Teknik.
4. Trajtimi financiar i drejtorit te Agjencise se Akreditimit barazohet me klasen B4 te lidhjes nr.1 "Renditja e funksioneve sipas klasifikimit", ndersa specialisteve me klazën IX te lidhjes II,M "Page baze sipas klasave per punonjesit e ministrive, institucioneve te tjera qendrore, RTV-se, ATSH-se dhe prefekturave".
5. Keshilli i Akreditimit miraton kriteret e vleresimit te brendshem, programor dhe institucional, te hartuara nga Agjencia e Akreditimit, miraton kerkesen e shkolles se larte per vleresimin perkates, si dhe periudhen gjate se ciles duhet te kryhet ky vleresim, vendos per rezultatin perfundimtar te vleresimit, sipas raportit te hartuar nga Agjencia e Akreditimit. Rezultati perfundimtar quhet pozitiv, kur plotesohen kriteret e caktuara. Ne te kundert quhet negativ. Kete rezultat keshilli ia paraqet per vendim Ministrit te Arsimit dhe Shkences.
6. Agjencia e Akreditimit harton kriteret e vleresimit te programeve dhe te institucioneve, te cilat ia paraqet per miratim Keshillit te Akreditimit dhe ua ben te njohura te gjitha shkollave te larta. Kjo agjenci regjistron kerkesat e shkollave te larta per vleresim institucional. Ajo,

gjithashtu, kryen vleresimin e programeve dhe vleresimin institucional. Rezultatet e vleresimit ia paraqet Keshillit te Akreditimit.

7. Ministria e Arsimit dhe Shkences, pas shqyrtimit te raportit te dhene nga Keshilli i Akreditimit, nese ai eshte negativ, merr vendimin per mbylljen ose jo te kurseve ekzistuese te studimit ose paraqet per miratim ne Keshillin e Ministrave mbylljen ose jo te shkollave ekzistuese te larta publike apo te strukturave te tyre perberese. Studenteve te ketyre kurseve apo shkollave u krijohet mundesia per vazhdimin e kursit te ngjashem ne nje shkolle tjeter te larte ne rast se eshte e mundur nje e tille. Kur nuk gjenden mundesi qe studentet ekzistues te perfundojne studimet, keto kurse lejohen te funksionojne vetem vitet qe kane mbetur per te perfunduar ciklin.

Ne rastin e arismit te larte jopublik, ne qofte se raporti i Keshillit te Akreditimit eshte negativ, kjo ministri merr vendim per mosnjohjen e kurseve ekzistuese te studimit ose i propozon Keshillit te Ministrave mosnjohjen e shkolles.

Keto procedura jane te vlefshme edhe per kurset e studimit ne shkollat pasuniversitare. Ne rastin e vleresimeve pozitive, Ministri i Arsimit dhe Shkences shpall nivelin e diplomes.

8. Procedura e vleresimit kryhet kur vete shkolla kerkon te vleresohet ose kur kete gje e kerkon Ministria e Arsimit dhe Shkences.

9. Nje dege apo shkolle e larte publike mund te funksionojne pa u akredituar per nje periudhe jo me shume se 4 vjet. Ne rast se shkolla nuk e kerkon vleresimin brenda kesaj periudhe, Ministria e Arsimit dhe Shkences duhet t'ia kerkoje kete vleresim Agjencise dhe Keshillit te Akreditimit.

10. Shkollat e larta jopublike marrin persiper te gjitha shpenzimet financiare per vleresimin dhe akreditimin e tyre, ne perputhje me aktet nenligjore perkatese.

11. Agjencise se Akreditimit, qe nga dita e krijimit ne p erputhje me kete vendim, i jepet nje afat kohor 6-mujor per hartimin e kriterëve te vleresimit te shkollave te larta.

12. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkences per zbatimin e ketij vendimi.

Ky vendim hyn ne fuqi pas botimit ne Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Pandeli Majko